# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441204**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shpërndanin lëndë narkotike/ Gjykata e Sarandës lë në burg 20 persona, mes tyre dhe te huaj |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/shperndanin-lende-e-ne-srande-gjykata-e-sarandes-le-ne-burg-2-i513094` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:32:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 14:29:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `621f67cfb2cb9e58fc50990877b6600bf8cbe07a880054ee3caadf2372e880af` |
| TEKSTI | `695670eb7601c6a0f01ed8c1b12ed0c2815af1afd4f40c82b4305ccc6c57f388` |
| PAMJA | `225b1790fb776a1489c0c4e74ffa0b518d8f0c6c28fbb0e0f97ddef53d2e779f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ee0374117fab3af85c3bd4cd551a9d63c05820a75bed5aece511c64bef93f643` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ee0374117fab3af85c3bd4cd551a9d63c05820a75bed5aece511c64bef93f643`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Shpërndanin lëndë narkotike/ Gjykata e Sarandës lë në burg 20 persona, mes tyre dhe te huaj

Sipas njoftimit të bërë publik nga Prokuroria, të arrestuarit bashkëpunonin me njëri-tjetrin në shpërndarjen e llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike si kanabis dhe kokainë.

dosja
8 Shtator 2026, 16:29
Nga G.M




Prokuroria e Sarandës

**SARANDË**- Një grup prej 20 personash është lënë në burg pas hetimeve të kryera nga Prokuroria e Sarandës për shpërndarje të lëndëve narkotike në Sarandë dhe Ksamil. Sipas njoftimit të bërë publik nga Prokuroria, të arrestuarit bashkëpunonin me njëri-tjetrin në shpërndarjen e llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike si kanabis dhe kokainë.

Droga shpërndahej në zona të frekuentura edhe nga turistë të huaj që dyshohet se kanë qënë klienta, si dhe pranë gjimnazeve.

**NJOFTIMI I PROKURORISE:**

"Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Sarandë u dha masa e sigurimit 'Arrest me burg' për 20 persona, të akuzuar për veprën penale 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve' parashikuar nga neni 283/1/2 të Kodit Penal.

Nga hetimet mbi procedimin penal nr.442 të vitit 2026, të nisura mbi bazën e informacionit referues të ardhur nga Komisariati i Policisë Sarandë, rezultoi se shtetasit në fjalë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kryenin shpërndarjen e lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme kryesisht kokainë por dhe cannabis. Shpërndarja bëhej prej tyre në qytetin e Sarandës dhe Ksamilit kryesisht në zonën e shëtitores, në plazhe, pranë gjimnazeve si edhe në Beach Bar-et për turistat.

Dyshohet se në këtë aktivitet, janë të përfshië edhe shtetas të huaj të cilët kontaktojnë shtetasit e akuzuar të blejnë doza me shumicë dhe kryejnë shpërndarjen e tyre në zonën e Ksamilit dhe të Sarandës. Lënda narkotike cannabis sativa dyshohet se sigurohet nga fshati Shenvasil apo fshatrat përreth.

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07
Analiza: Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45
Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

Në funksion të këtij procedimi, gjatë një periudhe dy mujore, u kryen veprime simuluese, përgjime ambientale ku është dokumentuar edhe shitja e lëndëve narkotike dhe janë arrestuar më herët shtetasit A.N, A.C dhe K.J të cilëve ju sekuestrua lëndë narkotike e llojit cannabis 4 kg. Dozat e shitura të lëndëve narkotike varionin nga 0.3g deri në 3.5g, ndërsa çmimet e dozave varionin nga 2000 lekë deri në 35.000 lekë për lloje të ndryshme të lëndëve narkotike.

Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, u vendos caktimi i masës së sigurimit 'arrest në burg' për 20 personat nën hetim:

1. A.O, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

2.F.F., i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

3. F.L, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

4. A.A, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

5.E.D, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

6. M.M, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

7. R.A, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

8. Dh.T, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

9. N.R, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

10. F.B, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

11.E.D, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

12. K.P, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

13. D.S, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

14. Xh.M, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

15. V.K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

16. B.K, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/1;

17.Sh.B, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal;

18.N.R, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2;

19. A.B, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2; dhe

20. K.O, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Prodhim dhe shitje narkotikësh' parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

Gjatë ekzkutimit të vendimit të caktimit të masave të sigurimit dhe vendimit për lejimin e kontrollit janë gjetur në banesë dhe janë sekuestruar ndër të tjera dy armë zjarri personave nën hetim D.S dhe Sh.B."**/Dosja.al**

prokuroria e sarandës | droge


BOTA 13 SHTATOR 2026, 09:34

Kremlini sjell në front reliktet e një princi të shekullit të 14-të

## më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

## insights

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi
REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Moti

Powered by tomorrow.io

## Sondazh

Poll

Aktualitet

8 Shtator 2026, 16:10

# Sheshi "Nënë Tereza“ do transformohet totalisht. Shikoni projektin (FOTO)

Pamje Sheshi “Nënë Tereza” pritet të ndryshojë në kuadër të një projekti të ri të Fondit Shqi...

### VIDEO/ Sot seanca e parë plenare, qytetarët në protestë, policia bllokon Rrugën e Elbasanit me gardh metalik

Aktualitet

8 Shtator 2026, 15:50

### VIDEO/ Zjarri përfshin ullishtet në Halil të Krujës, Kalaja: Banorët po fikin vetë flakët, kërkohet ndërhyrje urgjente

Aktualitet

8 Shtator 2026, 15:27

### Ellis: Aktgjykimi i Speciales mund të bëhet precedent për drejtësinë ndërkombëtare

Aktualitet

8 Shtator 2026, 15:30

### “Hajde, hajde, nxito!”/ Dy shqiptarë grabisin banesën e stilistes në Spanjë, teksa ajo ishte me fëmijët

Aktualitet

8 Shtator 2026, 15:10

Aktualitet

8 Shtator 2026, 15:06

# ‘Luajti’ kokafshehtas me policinë për 9 muaj, Ylli Zalla meret i pandehur për dy karroca me armë...

Ylli Zalla Ylli Zalla, njeriu që për 9 muaj me radhë “luajti” kukafshehtas me Policinë e Shtetit, është marrë...

## PISA 2025/ Shqipëria përmirësohet në matematikë dhe shkencë, por rezultatet kanë kufizime

Aktualitet

8 Shtator 2026, 14:35

## ‘Xhepat e forcës’/ BIRN: Kompanitë private të sigurisë po përdoren si ‘mercenarë’ të biznesit

Aktualitet

8 Shtator 2026, 14:31

## Shqiptarët prej më shumë se tre muajsh në protesta/ Gazetarja e CNN Isa Soares në mbështetje: Dita e 100-të e Revolucionit të Flamingove

Aktualitet

8 Shtator 2026, 14:21

## Rregullorja e GJKKO nuk lejon celularët në sallën e gjyqit, Avokatët vendosin për bojkot pa afat

Aktualitet

8 Shtator 2026, 14:00

MË SHUMË






Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha qepeni gojën



Dita e 106-të e protestës/ Nis marshimi drejt Kryeministrisë: Shqipëria kërkon revolucion




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.